



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 36

Prishtinë, më 01 dhjetor 2009, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Morën pjesë: Bahri Hyseni - kryetar, Bajram Kosumi, Adem Hajdaraj, Selvije Halimi, Ramadan Gashi, Armend Zemaj, Ibrahim Makolli dhe Kolë Berisha.

Munguan: Adem Salihaj, Vladimir Todorović dhe Mufera Şinik.

Të pranishëm: Georgi Rupchev – EU – AC project, Lorik Bajrami – Çohu, Lendita Kastrati - EU- AC, Mentor Borovci - AKK, Jetullah Aliu - AKK, Rrezarta Ahmeti - KDI dhe Visar Krasniqi – Zyra e Komisioneve të Kuvendit.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni - kryetar i Komisionit

R e n d i i d i t ë s

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 20 tetorit 2009;
3. Shqyrtimi i propozimamendamenteve të Projektligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë;
4. Shqyrtimi i përfundimit të Kryesisë së Kuvendit nr. 03-P-161/k për vendimin e Gjykatës Kushtetuese për masën e përkohshme të parapagimit të RTK-së;
5. Shqyrtimi i projektligjeve për bazë juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës;
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 20 tetorit 2009

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i propozimamendamenteve në Projektligjin për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë

Kryetari – I përshëndeti të pranishmit dhe monitoruesit e punës së Komisionit. Theksoi që kapitulli për dhuratat të kalojë në Projektligjin për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë. Për këtë do të formohet një nënkomision për amendamentim dhe të përcaktohet se në cilin kapitull të Projektligjit të vendoset. Në vazhdim i paraqiti propozimamendamentet për shqyrtim nga Komisioni.

Ibrahim Makolli - Lidhur me çështjen e dhuratave pyeti se a do të duhej të përfshiheshin vetëm zyrtarët e lartë publikë apo edhe kategori të tjera? Në këtë ligj janë përfshirë vetëm zyrtarët e lartë. Kjo për mua është pak e paqartë?

Armend Zemaj - Duke u ndërlidhur me parafolësin theksoi se në pikën e 6-të thuhet se kur zyrtari i lartë merr dhuratë duhet ta marrë pëlqimin e eprorit. Kjo do ta qartësonte çështjen e dhuratave.

Kryetari - Ua rikujtoi se çështja e dhuratave në një mënyrë është paraparë edhe në parimet e Ligjit për shërbimin civil, në Ligjin për administratën publike, si edhe në rregulloret e brendshme. Prandaj të përqendrohemi vetëm për zyrtarët e lartë publikë.

Ibrahim Makolli – Sërish ceku se ky ligj nuk i përfshin edhe kategoritë për të cilat po flasim. Edhe në rregulloret e brendshme të këtyre kategorive nuk ka diçka të saktësuar. P.sh.: Ligji për policinë nuk e parasheh çështjen e dhuratave. U pajtua se në këtë ligj nuk mund të futen edhe këto kategori, sepse kemi të bëjmë me zyrtarët e lartë publikë.

Kryetari – E paraqiti para Komisionit propozimin e ekspertit Georgi Rupchev, që në paragrafin 3 të nenit 10 kërkon të shtohet fjalia: “Përjashtimet sipas nenit 4, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit për qasjen në dokumentet zyrtare, nuk mund të zbatohen për t’u refuzuar qasja publike në regjistër”. E ftoi ekspertin ta arsyetonte propozimin.

Georgi Rupchev - Para Komisionit e paraqiti arsyetimin për propozimin, duke iu referuar Ligjit për qasjen në dokumentet zyrtare, si bazë që mund të merret për ta refuzuar qasjen në regjistër.

Mentor Borovci - Propozoi të mos i referohemi fare Ligjit për qasje në dokumentet zyrtare. Kjo do të thotë se të interesuarit me kërkesë mund të kërkojnë nga Agjencia qasje në regjistra.

Bajram Kosumi - Tha se e kuptonte që ky propozim ka për qëllim që zyrtarët e Agjencisë të mos e pengojnë qasjen në regjistër. Shtoi se të dhënat janë personale deri në momentin kur nuk futen në regjistër. Regjistri është dokument zyrtar, i cili duhet të ruhet në bazë të Ligjit për qasje në dokumentet zyrtare. U pajtua me parafolësin që në nenin 10, pika 3, të hiqet mbështetja në Ligjin për qasje në dokumentet zyrtare dhe ta lëmë procedurën sipas këtij ligji.

Mentor Borovci – Sërish i informoi për zgjidhjet që i kanë bërë vendet e rajonit, në të cilat të dhënat publikohen në faqe të internetit, me qëllim që publiku të ketë qasje.

Kryetari - Tha se do të ishte mirë që publikimi i pasurisë të bëhet në faqe të internetit. Në këtë mënyrë do të eliminoreshin proceduarat. Nëse keni ndonjë propozim konkret mund ta shqyrtojmë.

Mentor Borovci - Propozoi që në nenin 10, par. 3, të shtohet: “Deklarimet e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë të publikohen në faqe të internetit të Agjencisë”. Si të tilla do të mundësonin qasje për publikun.

Adem Hajdaraj - Tha se publikimi i të dhënave personale në faqe të internetit është shkelje e të drejtave personale dhe pa pëlqimin paraprak të personit nuk mund të publikohen.

Pas një diskutimi që u zhvillua Komisioni vendosi që në një takim të radhës të futen edhe propozimet e dala nga kjo mbledhje, në mënyrë që të gjendet një model që pasuria e zyrtarëve të lartë publikë të bëhet publike në faqe të internetit të Agjencisë.

4. Shqyrtimi i përfundimit të Kryesisë së Kuvendit nr. 03-P-161/k për vendimin e Gjykatës Kushtetuese për masën e përkohshme të parapagimit e RTK-së

Kryetari - I njoftoi për përfundimin e Kryesisë së Kuvendit, me të cilin kërkohet nga Komisioni që deri më 1 dhjetor të japë rekomandim për futjen e shumës 3.50 euro në faturat e KEK-ut. Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media ka nxjerrë rekomandim rreth kësaj çështjeje. Për këtë çështje hapi debat.

Bajram Kosumi - Tha se secili qytetar është i obliguar të paguajë për mediumin publik. Në vazhdim shtoi se nuk mendonte se ligji për RTK-në duhet të amendamentohet, sepse problem është kontrata ndërmjet RTK-së dhe KEK-ut. Ne do duhet t'i rekomandojmë Kryesisë ta shqyrtojë që të gjendet një model i financimit.

Selvije Halimi - Tha se edhe në mandatin e kaluar në Komisionin për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, anëtare e të cilit kam qenë, është diskutuar kjo çështje. Ne edhe atëherë kemi qenë kundër, mirëpo kjo është arsyetuar duke marrë shembuj nga vendet e rajonit, që e kanë këtë formë të arkëtimit, me qëllim që RTK-ja të mos ngarkohet me staf për terren. Mori shembull se ka familje me 3 njehsorë dhe ngarkohet për secilin, prandaj duhet të gjendet një model i përshtatshëm i financimit.

Adem Hajdaraj - Diskutoi për rekomandimin e Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media për financimin e RTK- së për 6 muajt e ardhshëm, që sipas tij është plotësisht i papranueshëm. Duhet të gjendet ndonjë model i përshtatshëm, por jo ky që po zbatohet.

Armend Zemaj - Ishte i mendimit se mënyra më e mirë është që Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media të fillojnë me amendamentimin e Ligjit për RTK-në, të përshpejtohet procedura, dhe në këtë mënyrë të definohen këto çështje.

Pas një debati që u zhvillua Komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Të inicohet procedura e ndryshimit dhe e plotësimit të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës.

Shqyrtimi i projektligjeve për bazë juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës

Komisioni e shqyrtoi bazën juridike:

të Projektligjit për shërbimin civil, të Projektligjit për pagat e shërbyesve civilë, të Projektligjit për mërgatën e Kosovës, të Projektligjit për financimin e partive politike, të Projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, të Projektligjit për shërbimet postare dhe të Projektligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010.

Komisioni vlerësoi se projektligjet bazën juridike e kanë në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë nuk pati diskutime.

E hartoi:
stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni